



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME

Numri i lëndës: 2022:241303

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05452629

**C-IV.-14-4421**

*Ankuesi*

**Xh Q** nga Drenasi.

*Përfaqësuar nga I Z D avokat nga Drenasi.*

Kundër

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)**, rr “Dritan Hoxha”, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrije Shala, me dt.08 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- Dhoma e Posaçme nuk ka juridiksion mbi propozim për përmbarim.**
- Lënda i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Drenas, si gjykatë kompetente për shqyrtimin e propozimit për përmbarim në këtë fazë të procedurës .**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.09 qershor 2014, paditësi përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur padi kundër të paditurës NSH “Ferronikeli” dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit me objekt të kontestit Realizim i borxhit në vlerë prej 12,754.06€. Me të njëjtën ka kërkuar që të aprovet kërkesëpadija e paditësit në bazë të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Glllogoc E.nr.385/07, dhe të detyrohet e paditura që të ia paguaj borxhin në bazë të marrëveshjes gjyqësore P1 (C1).nr.733/97 dt.30.01.1998, e plotëfuqishme me dt.30.01.1998 në emër të të ardhurave personale dhe regresit për periudhën 18.11.1992 deri me dt.01.10.1997 në shumën e atëhershme prej 59,100.00 dinarë, me kamatë ligjore duke filluar nga dt.01.01.1998 deri në pagesën e tërësishme, si dhe të ia kompensojë shpenzimet e procedurës Kontestimore në shumë

prej 2,337.000 Dinarë të atëhershëm, të gjitha në afat prej 8 ditësh nga dita e lidhjes së marrëveshjes, nën kërcënim të përmbarimit. Kjo vlerë sipas konvertimit të bërë nga eksperti financiar me kamatë nga dt.18.11.1992 e deri me dt.23.03.1999 arrin shumën prej 12,754.06€ si dhe shpenzimet e procedurës së përmbarimit në shumë prej 117 € në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim, si dhe shumën prej 50.€ në emër të taksës gjyqësore.

### **Arsyetimi ligjor**

Pas vlerësimit të të gjithave provave të deponuara në këtë lëndë Gjykata konstatoi si në vijim: Dhoma e Posaçme nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me këtë çështje juridike.

Me nenin 26 të Ligjit për Gjykatat e rregullta (Gaz.Zyr. e KSA të Kosovës, nr.21/78) në par.14 përcaktohet se gjykatat komunale janë kompetente, për të vendosur për procedurën e trashëgimisë, përmbarimit, regjistrimit të të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme, në rastet e ndarjes fizike, rregullimin e çështjes së kufijve, vërtetimin e transkriptove, dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve, si dhe çështjeve tjera jashtëgjyqësore të cilat janë me ligj të vëna në juridiksionin e gjykatës. Ky ligj është shfuqizuar me nenin 42 par.1 të Ligjit për Gjykatat i cili ka hyrë në fuqi me dt.01 janar 2013.

Bazuar në nenin 5 par.1 pika 1.5 i Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme përcakton juridiksionin ekskluziv, *“kërkesa që pretendojnë një të drejtë, titull apo interes në lidhje me:*

*1.5.1. çfarëdo pasurie apo prone mbi të cilën Agjencia apo AKM-ja ka apo ka shpallur autoritetin administrativ;*

*1.5.2. pronësinë e një Ndërmarrjeje apo Korporate;*

*1.5.3. pronësinë mbi kapitalin e një Ndërmarrjeje apo Korporate, ose*

*1.5.4. çfarëdo prone apo pasurie në posedim apo kontroll të një Ndërmarrjeje apo Korporate, nëse një e drejtë, titull apo interes i tillë pohohet të ketë lindur gjatë apo para kohës kur ajo Ndërmarrje apo Korporatë i është nënshtruar autoritetit administrativ të AKM-së apo Agjencisë;”*

Duke pasur parasysh këto rrethana faktike dhe juridike, Dhoma e Posaçme nuk është kompetente për të gjykuar çështjet përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë i bart shpenzimet e veta. Paditësi e ka paguar taksën gjyqësore me dt.16 nëntor 2022.

## **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Gjyqtarja,**  
Hajrije Shala